



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 281/004

Dt 03.03.2017

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2017, mori:

**VENDIM**

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Bashkim Musliut me nr. prot. 139 të datës 3.2.2017, e paraqitur kundër vendimit të Senatit për përzgjedhjen e personelit akademik në bazë të konkursit të shpallur më 31.10.2016 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi vendimi i Senatit me nr. prot. 58/004, i datës 20.01.2017, për përzgjedhjen e kandidatës Violetë Bardh-Zeqiri në pozitën "Një mësimdhënëse për lëndët: Letërsi për fëmijë, Metodologji e leximit letrar", në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

**Arsyetim**

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Letërsi për fëmijë, Metodologji e leximit letrar, në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Pas shpalljes së njoftimit mbi kandidatët e suksesshëm më 20.01.2017, në ueb-faqen zyrtare të UMIB-it, ankimuesi Bashkim Musliu ka paraqitur ankesë me nr. prot. 139 të datës 3.2.2017, ndaj vendimit të Senatit për përzgjedhjen e personelit akademik në bazë të konkursit të shpallur më 31.10.2016 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtrësia, konstatoi se propozimi i Komisionit recensues dhe përzgjedhja e kandidatës së suksesshme është bërë, duke marrë parasysh kualifikimin dhe përvojën e mëhershme të saj në fushën përkatëse. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it